



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1770/3 Prot.

Tiranë, më 17.07.2025

VENDIM

Nr. 40 Datë 17.07 2025

**“PËR
PJESËMARRJEN E UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS SI
PARTNER NË KONFERENCËN E 24-TË NDËRKOMBËTARE SHKENCORE
ME TEMËN "SPORTI, AKTIVITETI FIZIK DHE SHËNDETI: PERSPEKTIVA
BASHKËKOHORE”**

Mbështetur në nenin 3 dhe 49 të Ligjit nr. 80/2015 'Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë', në Vendimin e Rektoratit nr. 83 datë 11/07/2025 "Për propozimin e nënshkrimit të marrëveshjes për pjesëmarrjen e Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 24-të Ndërkombëtare Shkencore me temën "Sporti, Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti: Perspektiva Bashkëkohore", në Vendimin e Senatit Akademik nr 84 datë 14.07.2025, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 17.07.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e pjesëmarrjes së Universitetit të Sporteve të Tiranës si partner në Konferencën e 24-të Ndërkombëtare Shkencore me temën "Sporti, Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti: Perspektiva Bashkëkohore" e organizuar nga Akademia e Sportit të Malit të Zi nga data 16 deri më 19 prill 2026, në Budva - Mali i Zi.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademike-Shkencore të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al dhe tek transparenca universitare.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur COBANI

